



**Syndicat
interprofessionnel
de travailleuses
et travailleurs**

16, Chaudronniers - case 3287 - 1211 Genève 3
téléphone : 022 818 03 00 - fax : 022 818 03 99
www.sit-syndicat.ch - e-mail : sit@sit-syndicat.ch

Dorëzmi i petitionit drejtuar Këshillit Federal të Konfederatës së Zvicrës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes Ambasadës së Republikës së Kosovës në Bern.

Bern, më 4 maj 2010

PËR RUAJTJEN E NJË KONVENTE PËR SIGURIME SOCIALE NE MES ZVICRËS DHE KOSOVËS

Merr fjalën Shani Zekolli, Sekretar Sindikal në Sindikaten SIT (Gjenevë)

Sindikata SIT, aktive në të gjitha sektoret, ka shumë vite që mbrojnë punëtorët migrant, qoftë me përmes akcioneve kolektive qoftë përmes mbrojtjes në raste individuale. Një nga prioritetet tona është barazia sociale dhe ekonomike mes të gjithë punëtorëve dhe punëtoreve që janë aktiv në Zvicër.

Sindikata SIT angazhohet në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve nga Kosova që nga vitet e 80-ta duke e kundërshtuar statusin e punëtorit sezonal ; pastaj gjatë viteve 90-ta kur punëtorët nga Kosova Zvicra i futi në rrethin e trete në kuadër të politikës së saj migruese, gjë që shkaktoi humbje të vendeve të punës për dhjetëra mijëra punëtore nga Kosova dhe një varfërim në rritje si rrjedhim si pasojë e mungesës së vullnetit për t'ua legalizuar qëndrimin . Në vitin 1999 duke organizuar riatdhësimin me aeroplan, dy herë rradhazi, për disa dhjetëra familje të anëtarëve tonë të mbetur refugjat në kampet e Stankovecit të Maqedonisë ; dhe gjatë viteve 2000 kur Sindikata SIT demonstroi angazhim të jashtëzakonshëm në rregullimin e kushteve të qëndrimit të dhjetëra familjeve që Zvicra donte t'i kthen në Kosovën e shkatëruar nga lufta.

Sot, pasi Zvicra denoncoj konventën për sigurime sociale në mes Zvicrës dhe Kosovës. Edhe një herë mijëra punëtore dhe punëtor Kosovar që punojnë këtu paguajnë çmim të lartë të një politike të pamenduar mirë dhe diskriminuese.

Edhe një herë, Zvicra po e stigmatizon punëtorin e huaj i cili kontribon për prosperitetin e saj

Këto punëtore dhe punëtor nuk do të kenë më mundësi për ta marrë pensionin në vednlindjen e tyre në formë pensioni e as të marrin pension invalidor eventual, kurse punojnë në sektore profesionale ku rreziqet për aksidente janë posaqërisht të larta

Nëse kësaj situatë ia shtojmë edhe faktin që ligji për të huajt parasheh edhe debimin e punëtorëve dhe punëtorve të huaj të cilët nuk kanë të ardhura të mjaftueshme, kjo paraqet kulmin e hipokrizisë.

Kjo politikë çon kah dëbimi, pa asnjë mbrojtje sociale, të punëtoreve dhe punëtorëve të cilët e kanë humbur shëndetin në Zvicër, me destinacion kah një shtet të ri i cili duhet të mban mbi supë konsekuencat.

Poashtu, jemi të shokuar me konstatimin se fëmijte që kanë mbetur në Kosovë, prindërit e të cilëve kontribuojnë në sigurimet sociale Zvicëriane, tani e tutje nuk do të marrin shtesat familjare, shtesa të cilat kontribuojnë shumë në edukimin dhe shkollimin e tyre

Sindikata SIT ka filluar në Gjenevë dhe në Kosovë një fushatë informimi dhe një peticion kundër këtij vendimi të njëanshem pranë Këshillit Federal të Konfederatës Zvicëriane për të denoncuar një konvente për sigurime sociale me Kosovën e cila ka konsekuenca ekonomike dhe sociale shumë të rëndësishme për punëtorët dhe punëtoret e këtij komuniteti në Zvicër.

Ky vendim është në kundërshtim me angazhimet e deklaruara të Zvicrës për ta njohur dhe perkrahur shtetin e ri të Kosovës, shtet i cili ka nevojë për një bashkëpunim afatgjatë ekonomik, social dhe institucional.

Për këtë arsye, Sindikata SIT :

- **kërkon ruajtjen e një konvente për sigurime sociale ne mes Zvicrës dhe Kosovës**
- **Kërkon që dy shtetet të fillojnë menjëherë negociimin e një konvente.**